



| | | | |
|---------------------------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Plana / Potezua Priljena/Prifato Received/Delivry | 05.11.2020 | viti god year | 0 |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/SHCK | 2446/2020 | | 119 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.264/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.264/2020 të datës 09.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga fshati Palaj rr."Bunajl" Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit - Komuna e Obiliqit,, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.264/2020, e datës 09.09.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted].

II. ANULOHET procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 30.06.2020, e shpallur nga Komuna e Obiliqit për pozitën "Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm" në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Obiliqit.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Obiliqit dhe Menaxheri i Personelit në Komunën e Obiliqit, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Obiliqit bazuar në autorizimin e datës 30.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 30.06.2020, ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën e lire të punës "Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm" në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim.

Ankuesi [redacted] ka aplikuar në konkursin e lartpërmendur të shpallur nga Komuna e Obiliqit, për pozitën "Zyrtar për Kthim te Qëndrueshëm" në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim, i njëjti është kualifikuar për të hyrë në listë të ngushtë dhe është ftuar në test me shkrim. Ankuesi me datën 14.08.2020 ka marrë pjesë në testim me shkrim por nuk e ka kaluar testin me shkrim.

Ankuesi [REDACTED] [REDACTED] i pakënaqur me njoftimin e publikuar nga Komuna e Obiliqit, me datë 27.08.2020, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën “Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm” në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim, në Komunën e Obiliqit me datën 09.09.2020, ka parashtruar ankesë direkt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër të protokollit 1708/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 21.09.2020, kërkesën për përgjigje në ankesë e ka proceduar tek Komuna e Obiliqit, ndërsa me datë 02.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Obiliqit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës

Administrimi i provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1708/20120 të datës 09.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 02.10.2020 nga Komuna e Obiliqit; Autorizim për publikim të konkursit i datës 30.06.2020; Konkurs i datës 30.06.2020; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës i datës 29.07.2020; Raport nga komisioni përzgjedhës i datës 03.08.2020; Raport i komisionit intervistues i datës 19.08.2020; Njoftim i datës 19.08.2020, Rekomandim nga KPSHC i datës 26.08.2020; Njoftimi i datës 27.08.2020, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Testi me shkrim i datës 14.08.2020; Qelësi i përgjigjeve të testit me shkrim i datës 24.08.2020; Kërkesa për punësim të kandidatës Drita Krasniqi e datës 09.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Valon Kastrati e datës 13.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatës Qendresa Jerliu-Mjekiqi e datës 13.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Sylejman Aliu e datës 14.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Visar Aliu e datës 10.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit [REDACTED] [REDACTED] e datës 10.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Besart Berisha e datës 10.07.2020; Kërkesa për punësim të kandidatës Gentiana Sadiku e datës 07.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatës Rabije Xhigoli e datës 13.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Fidan Krasniqi e datës 07.07.2020; Kërkesa për punësim të kandidatit Zeqir Vershevcu e datës 10.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatës Jelena Popovic e datës 14.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatës Florentina Gashi e datës 14.07.2020; Kërkesa për punësim të kandidatës Vildane Gashi e datës 06.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Kërkesa për punësim të kandidatit Bekim Krasniqi e datës 06.07.2020 me shkresat e bashkëngjitura; Vendimi me numër 6/2020 i datës 22.10.2020 i KPMSHCK-së për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A. Nr. 264/2020 të datës 09.09.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED].

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit [REDACTED] [REDACTED], është e bazuar, për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale në procedurën e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm” në Komunën e Obiliqit sipas konkursit të shpallur të datës 30.06.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 30.06.2020 nga Komuna e Obiliqit për pozitën “Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm” në Komunën e Obiliqit, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare; Jurist, Ekonomist, Administratë Publike, Inxhinier për Mbrojtje të Mjedisit*
- *Pa përvojë pune/ ose shkollë e lartë 2 (dy) vite përvojë pune*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se konkursi për pozitën *“Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm”* në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim, ka qenë i publikuar nga data 30.06.2020 deri me datën 14.07.2020, ndërsa Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil listën e shkurtër e ka përgatitur në kundërshtim me dispozitat e nenit 26 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit”*, çka nënkupton se lista e shkurtër është përgatitur me date 03.08.2020 jashtë afatit ligjor, respektivisht pasi kanë kaluar më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë pune prej momentit kur është mbyllur konkursi si dhe pas njëmbëdhjetë (11) dite pune është themeluar Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i datës 29.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil për procedurën e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm”* në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim, testin me shkrim e kanë mbajtur me datë 14.08.2016, ndërsa intervistën me gojë me datë 24.08.2020 që është kundërshtim me nenin 32 paragrafin I të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“Testimi i kandidatëve, të cilët janë përfshirë në listën e shkurtër behët brenda, 10 ditë pune pas marrjes së listës së shkurtër përfundimtare”*, e që rastin konkret është jashtë afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës prej momentit të përgatitjes përfundimtare të listës së shkurtër sepse në bazë të dëshmive të ofruara lista e shkurtër është formuar me datë 03.08.2020 jashtë afatit të parapare ligjor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i themeluar në bazë të Vendimit me Nr.11/832 të datës 29.07.2020, nuk ka qenë i themeluar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se *„Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad Hoc të Shërbimit Civil i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. Komisioni përzgjedhës ad Hoc i Shërbimit Civil përbëhet nga anëtarët të cilët kanë pozita më të larta, se pozita që duhet të rekrutohen, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jete shumetnik dhe me përfaqësim gjinor, KPSHC, zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitën e karrierës dhe të jo karrierës”*. Në bazë të dëshmive të ofruara, konkretisht në bazë të Akt emërimit të datës 01.01.2013, Akt emërimit të datës 01.08.2016 dhe Akt emërimit të datës 03.05.2011 të anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil është konstatuar se përbërja e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse në Komision është emëruar një nëpunëse civile, që e ka pozitën më të ulët dhe dy nëpunëse civile që e kanë pozitën e njëjtë me pozitën që është rekrutuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Obiliqit ka bërë shkelje të afateve ligjore lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm”* në Zyrën Lokale për Komunitete dhe Kthim, sepse konkursi i shpallur me datë 30.06.2020 është mbyllur më datë 14.07.2020, ndërsa njoftimi për kandidatët e përzgjedhur është bërë me datë 27.08.2020, andaj e tërë procedura prej shpalljes së konkursit e deri tek përzgjedhja e kandidatit për këtë pozitë ka zgjatur (2) muaj, e që është shkelje e afateve ligjore të përcaktuara më Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marrë parasysh shkeljet procedurale të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit e zhvilluar nga Komuna e Obiliqit, është bërë në kundërshtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Obiliqit, në lidhje me zhvillimin e procedurave të rekrutimit si dhe përzgjedhjen e kandidatit ka vepruar në kundërshtim me neni 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet se: „Pranimi në *Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve*”.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmar të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 264/2020

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- **Ankuesit** [REDACTED]
- **Kryetarit të Komunës së Obiliqit;**
- **Menaxherit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe**
- **Arkivit të KPMSHCK-së.**

